



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:238868

Datë: 15.12.2022

Numri i dokumentit: 03758106

C.nr.3347/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.J, A.J, G.J dhe J.J, të gjithë nga P....., Komuna S....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Blerim Syla, avokat në Prishtinë, Rruga “UÇK”, Hyrja 261, kati I, numër 5, kundër të paditurave Kompania e sigurimeve “S.....” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kujtim Pula, jurist pranë të paditurës, dhe Kompania e sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Adnan Pacolli, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, vlera e kontestit 24,473.00€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 06.12.2022, të mbajtur me prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së parë dhe në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës së dytë, me datë 15.12.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.J, G.J dhe J.J, të gjithë nga fshati P....., Komuna e S.....t.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, që paditësve A.J dhe G.J, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.10.2012, nga baza e auto përgjegjesisë, për 70 % të përgjegjesisë, t’ia paguaj shumat si vijon:

Paditësit A.J

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 840.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 588.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej ..... 70.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 70.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 16.10€

#### Paditësit G.J

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 924.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 646.80€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej ..... 70.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 70.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 21.00€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, që paditësve A.J, G.J dhe J.J, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.10.2012, nga baza e auto përgjegjësisë, për 30% të përgjegjësisë, t’ua paguaj shumat si vijon:

#### Paditësit A.J

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 360.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 252.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej ..... 30.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 30.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 6.90€

#### Paditësit G.J

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 396.00€

- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 277.20€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 30.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 30.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 9.00€

#### Paditësit J.J

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 618.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 432.60€
- Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej ..... 1,080.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 120.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 120.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 6.00€

IV. DETYROHEN të paditurat Kompania e Sigurimeve “S.....” dhe Kompania e Sigurimeve “S.....”, që paditësve prestimet si në pikën –II- dhe –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ua paguajnë me kamatëvonesë si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar, dhe atë për dëmin material nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, 24.12.2012, ndërsa për dëmin jo material, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 15.12.2022, e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve A.J, G.J dhe J.J, mbi shumat e aprovuara si në pikën –II- dhe –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: Për paditësin A.J: për dhimbje trupore - fizike shumën prej 2,300.00€, për frikën e pësuar shumën prej 1,660.00€ dhe për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 200.00€. Për paditësin G.J për dhimbje trupore - fizike shumën prej 2,180.00€, për frikën e pësuar shumën prej 1,576.00€, për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 300.00€ dhe për shpenzime materiale të shërimit shumë prej 110.00€. Për paditësin J.J për dhimbje trupore - fizike shumën prej 782.00€, për frikën e pësuar shumën prej 567.40€, Për

shëmtim trupor, shumën prej 2,920.00€, për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 160.00€ dhe për shpenzime materiale të shërimit shumën prej 14.00€.

VI. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R.J nga fshati P....., Komuna e S.....t, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.10.2012, nga baza e auto përgjegjësisë, për diferencën e kompensimit të dëmit të pa paguar, nga 50% në 70% të përgjegjësisë, t’ia kompensojë shumat: për dhimbje trupore - fizike shumën prej 2,450.00€, për frikën e pësuar shumën prej 1,750.00€, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumën prej 70.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 70.00€, për rehabilitim shumën prej 21.00€ dhe për shpenzime materiale të shërimit shumën prej 40.00.

VII. DETYROHEN të paditurat që paditësve nga pika si në pikën –I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 2,267.18€ (dymijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e tetëmbëdhjetë centë) dhe atë e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për 70% të përgjegjësisë, për të dy paditësit, shumën prej 1,505.42€, ndërsa e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për 30% të përgjegjësisë, për të tre paditësit, shumën prej 832.74€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

#### A r s y e t i m

Paditësit R.J, A.J, G.J dhe J.J, të gjithë nga P....., Komuna S....., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 24.12.2012, në këtë Gjykatë, kanë ushtruar padi, kundër të paditurave Kompania e sigurimeve “S.....” Sh.A. dhe Kompania e sigurimeve “S.....” Sh.A., që të dyja me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë theksuar se me datë 25.10.2012, në Sllatinë, Komuna e Fushë Kosovës, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugor. Pjesëmarrës në këtë aksident ishin automjeti i markës “BMW”, me numër të targave 01....., i siguruar tek e paditura Kompania e

Sigurimeve “S.....” Sh.A., dhe automjeti i markës “OPEL Kadet”, me numër të targave 02....., i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A. Paditësi R.J, ditën kritike, ishte në cilësi të drejtuesit të automjetit me numër të targave 02....., kurse paditësit A.J, G.J dhe J.J, në cilësinë e udhëtarëve në po të njëjtin automjet. Të gjithë paditësit kanë pësuar lëndime trupore, ditën e aksidentit janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për ndihmë mjekësore. Si pasojë e aksidentit paditësit kanë pësuar dëm material dhe jo material. Ka shtuar se përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit ka i siguruari tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A, ndërsa përgjegjësi sekondare i siguruari tek e paditura “S.....” Sh.A. Mbi bazën e kësaj i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, dhe të detyrohen të paditurat që t’ua kompensojnë dëmin material dhe jo material, dhe atë: paditësit A.J, të dy të paditurat në mënyrë solidare, për dhimbje trupore - fizike shumë prej 3,500€, për friken e pësuar shumë prej 2,500.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 100.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumë prej 100.00€, për rehabilitim shumë prej 200.00€ dhe për shpenzime të shërimit shumë prej 23.00€. Paditësit G.J, të dy të paditurat në mënyrë solidare, për dhimbje trupore - fizike shumë prej 3,500€, për friken e pësuar shumë prej 2,500.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 100.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumë prej 100.00€, për rehabilitim shumë prej 300.00€ dhe për shpenzime të shërimit shumë prej 140.00€. Paditësit J.J, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për 30% të përgjegjësisë, për dhimbje trupore - fizike shumë prej 1,400€, për friken e pësuar shumë prej 1,000.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 120.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumë prej 120.00€, për rehabilitim shumë prej 160.00€ dhe për shpenzime të shërimit shumë prej 20.00€. Paditësit R.J, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për diferencën mes kompensimit të realizuar në procedurë jashtëgjyqësore (50% të përgjegjësisë) dhe përgjegjësisë së të siguarit tek e paditura (70% e përgjegjësisë), për dhimbje trupore - fizike shumë prej 2,450€, për friken e pësuar shumë prej 1,750.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 70.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumë prej 70.00€, për rehabilitim shumë prej 210.00€ dhe për shpenzime të shërimit shumë prej 40.00€. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12% në vit, nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar në shumë të përgjithshme prej 7,701.40€ dhe atë: për padi shumë prej 624.00€, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 624.00€, për përfaqësimin e paditësve nga avokati në shtatë seanca gjyqësore shumë prej 5,678.40€ (811.20€ x 7 seanca), për nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit shumë prej 150.00€, për nxjerrjen e provave me ekspertiza mjekësore shumë prej 600.00€ dhe për taksë

gjqësore për padi shumë prej 25.00€.

E paditura Kompania e Sigurimeve "S.....", në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, pjesërisht e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, në kuptim të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, me pretendimin se deri te aksidenti ka ardhur edhe me lëshimet e të siguruarit të të paditurës së dytë dhe se në bazë të ekspertizës së komunikacionit vërtetohet se përgjegjësia e të dy të paditurave është ndarë në mënyrë të barabartë, në proporcion 50% me 50%. I ka propozuar gjykatën që për paditësit A.J dhe G.J kërkesëpadinë ta aprovojë pjesërisht, në shumë prej 700.00€, për secilin paditës, kurse për paditësin R.J, kërkesëpadinë ta refuzojë në tërësi pasi që i njëjti për dëmin e pësuar është kompensuar në procedurë jashtëgjyqësore. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjyqësore, i ka propozuar gjykatës që zbatoj dispozitën e nenit 452, paragrafi 2, të LPK-së.

E paditura Kompania e Sigurimeve "S.....", në përgjigjen e saj në padi dhe në seancat gjyqësore, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve vetëm për nga lartësia, duke theksuar se pranon përgjegjësinë në përputhje me kontributin e të siguruarit të saj, në shkallë prej 20%.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raportin e aksidentit 2012-AR-1909, të datës 25.10.2012, Kallëzimin penal me numër të rastit 2012-AR-1909, të datës 25.10.2012, përpiluar nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor Prishtinë, ekspertiza e komunikacionit e datës 05.08.2020, punuar nga eksperti Skender Shala, si dhe ekspertizat mjekësore nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë, të punuara me datë 05.03.2021, nga ekspertët Dr. Milazim Haxholli - Ortoped, dhe Dr. Bujar Obertinca – Psikiatër. Po ashtu si prova janë administruar edhe dokumentacioni mjekësor, kuponët fiskal dhe dëftesat lidhur me shpenzimet e shërimit dhe atë: Për paditësin R.J: Raportin e Qendrës Klinike Universitare me numër 34138, të datës 25.10.2012; Raportet e Qendrës Spitalore me numër 8300, të datës 06.11.2012, me numër 9915, të datës 06.11.2012, me numër 7770, të datës 06.11.2012; Raportet nga konsultat me numra 3946 dhe 15265, që të dyja të datës 01.11.2012, Dëftesat me numra: 0789910, 0775711, 0788837, 0794296, 0771236 dhe Marrëveshja Jashtëgjyqësore lidhur me datën 27.03.2013, në mes Kompanisë së Sigurimeve "S....." dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditësit R.J, me numër të referencës 787/12. Për paditësin A.J: Raportin e Qendrës Klinike Universitare me numër 34139, të datës 25.10.2012, Raportin e Qendrës Spitalore me numër 8301, të datës 06.11.2012, Raportet nga Konsultat me numra 3947,

të datës 01.11.2012 dhe me numër 1526, të datës 01.12.2012, Vërtetimi për shfrytëzimin e mbrojtjes shëndetësore të punëtorëve, me numër 144, kuponët fiskal me numra 8024, i datës 29.10.2012 dhe me numër 0010, i datës 29.10.2012, dëftesat me numra 0753479, 0771237, 0794295, 0788836 dhe 0034255. Për paditësin J.J Raportin e Qendrës Klinike Universitare me numër 34141, të datës 25.10.2012, Raportet e Qendrës Spitalore me numra 3945 dhe 15268, të datës 01.11.2012, me numër 8299, të datës 06.11.2012, me numra 15600, 1036, të datës 08.11.2012, Raportin e Qendrës Spitalore të datës 08.11.2012, të lëshuar nga QKUK – oftamologu, Raportin e Qendrës Spitalore të datës më numër 16243, të datës 22.11.2012, Raportin nga Konsulta e datës 31.10.2012, lëshuar nga I.P.Sh. “Syri”, dëftesat me numra 0775656, 0790089, 0775082, 0775568, 0788838, 0771235 dhe 0794301, si dhe Marrëveshjen Jashtëgjyqësore me numër të referencës 790/12, të lidhur me datën 27.03.2013, në mes Kompanisë së Sigurimeve “S.....” dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditësit J.J. Për paditësin G.J: Raporti i Qendrës Klinike Universitare me numër 34140, i datës 25.10.2012, Raportet e Qendrës Spitalore me numra 7771, 8298 dhe 9916, të datës 06.11.2012, Konstatimi Radiologjik, i datës 25.10.2012, Raportet nga konsultat me numra 15266 dhe 3948, që të dy të datës 01.11.2012, Kuponi fiskal me numër 2, i datës 05.11.2012 dhe dëftesat me numra 0753478, 0034256, 0771239, 0789911, 0775712, 0794302 dhe 0788839.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve A.J, G.J dhe J.J, kurse refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit R.J, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 25.10.2012, në Sllatinë Komuna e Fushë Kosovës, është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor, në të cilin ishin përfshirë automjetet me numër të targave 01....., i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A., dhe automjetit me numër të targave 02....., i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A.

Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se në aksidentin e datës 25.10.2012, lëndime kishin pësuar të gjithë paditësit, të cilët në kohën e aksidentit ishin në automjetin me numër të targave 02....., dhe atë paditësi R.J drejtues i automjetit, kurse A.J, G.J dhe J.J udhëtar në këtë automjet. Këto fakte jo kontestuese provohen edhe me raportin e aksidentit numër 2012-

AR-1909, të datës 25.10.2012, të përpiluar nga Policia e Kosovës dhe me ekspertizën e komunikacionit rrugor 05.08.2020, punuar nga eksperti Skender Shala.

Nga Ekspertiza e Komunikacionit Rrugor datës 05.08.2020, e punuar nga eksperti Skender Shala, dhe sqarimet të dhëna në seancën gjyqësore të datës 16.12.2020, është provuar fakti se shkaktar primar i aksidentit të datës 25.10.2012, është drejtuesi i automjetit me numër të targave 01-15-BL, i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....”, ndërsa lëshimet e drejtuesit të automjetit me numër të targave 02....., konsiderohen si kontribut në aksident.

Gjykata ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë, e punuar sipas vëllimit të detyrave të dhëna nga gjykata, prandaj të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 70 % për të paditurën e parë, Kompaninë e Sigurimeve “S.....” Sh.A. dhe 30% për të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve “Siguaria” Sh.A.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kërkesëpadisë, si dhe baza juridike për paditësin R.J, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga raporte mjekësore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente me numra 34138, 34139, 34141 dhe 34140, që të gjitha të datës 25.10.2012, është vërtetuar fakti se në ditën e aksidentit, të gjithë paditësit janë paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, i cili ka evidentuar lëndimet e pësuar të paditësve dhe të njëjtët kanë pranuar edhe tretman mjekësor.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.09.2013, e lidhur mes Kompanisë së Sigurimeve “S.....” dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, tani paditësit R.J, gjykata ka provuar faktin se paditësi është kompensuar për dëmin e pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.10.2012, bazuar në proporcionin e përgjegjëse së pranuar nga të dy palët, dhe të njëjtët janë dakorduar që i dëmtuarit nuk do të bëjë kërkesë dhe nuk do të ushtroj padi në të ardhmen për dëmin e pësuar dhe nëse ka ushtroar padi, të njëjtën do ta tërheq.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 27.03.2013, e lidhur mes Kompanisë së Sigurimeve “S.....” dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, tani paditësit J.J, gjykata ka provuar faktin se paditësi nga e paditura e parë është kompensuar për dëmin e pësuar në aksidentin e



komunikacionit të datës 25.10.2012, bazuar në proporcionin e përgjegjëse së pranuar nga të dy palët, dhe të njëjtit janë dakorduar që i dëmtuarit nuk do të bëjë kërkesë dhe nuk do të ushtroj padi në të ardhmen për dëmin e pësuar dhe nëse ka ushtruar padi, të njëjtën do ta tërheq.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Dr. Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi A.J, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, si përdredhje e indeve të buta të qafës dhe ndrydhje koke, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 1 ditë, kohë pas kohe gjerë në marrjen e terapisë adekuate, duke marr parasysh lëndimet e qafës, krahut, barkut të cilat nuk mund të mobilizohen dhe japin dhimbje në çdo lëvizje. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 18 ditësh, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cila ndërlihen me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka ende, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 18 ditësh, që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë joprofesionale nga anëtarët e familjes, ndihmë kjo e ofruar për personin e lënduar, e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike, si: veshje, zhveshje, higjiena personale, kryerje e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mund t'i plotësojë vet, si pasojë e paaftësisë së pjesshme. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi A.J, si pasojë e aksidentit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, si reagim i fuqishëm ndaj rrezikut të çastit (frikë nga vdekja

mentale). Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, e shfaqur në formë të konfuzionit, të brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja, të cilat i kanë shkaktuar ankth, pagjumësi, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende, herë pas here.

Eksperti ortoped, Dr. Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *G.J.*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, si përdredhjeje e indeve të buta të regjionit të qafës dhe ndrydhje në bërrylin dhe krahun e majtë, ndrydhje në bark nga ana e majtë, të cilat cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të lartë ka pasur 1 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, duke marr parasysh lëndimet e qafës, krahut dhe barkut, të cilat nuk mund të mobilizohen dhe japin dhimbje në çdo lëvizje. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 20 ditësh, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cila ndërliken me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka ende, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 20 ditë, që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë joprofesionale nga anëtarët e familjes, ndihmë kjo e ofruar për personin e lënduar, e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike, si: veshje, zhveshje, higjiena personale, kryerje e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mund t'i plotësojë vet, si pasojë e paaftësisë së pjesshme. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 20 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 20 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *G.J.*, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, si reagim i fuqishëm ndaj rrezikut të çastit (frikë nga vdekja momentale). Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, e shfaqur në formë të konfuzionit, të brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja, të cilat i kanë shkaktuar ankth, pagjumësi, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende, herë pas here.

Eksperti ortoped, Dr. Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *J.J.*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të rënda trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: thyerje shumëpjesëshe e kockës së rrezorit të majtë në pjesën të cilën e formon nyjën e bylyzykut të dorës, ndrydhje të regjionit të qafës, kokës dhe ndrydhje shpine. Paditësi ka përjetuar dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 45 minutash, nga koha e kaluar nga aksidenti, transporti, procedurat diagnostifikuese dhe invazive, e deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 3 ditë, për shkak të thyerjeve shumëpjesëshe të eshtrave. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 50 ditësh, kohë pas kohe gjerë në marrjen e terapisë adekuate kundër dhimbjeve, e cila ndërlihet me kohën e nevojshme për konsolidimin e thyerjes, ndërrimet e mobilizimit. Dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe tani. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 60 ditë, që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë joprofesionale nga anëtarët e familjes, ndihmë kjo e ofruar për personin e lënduar, e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike, si: veshje, zhveshje, higjiena personale, kryerje e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mund t'i plotësojë vet, si pasojë e paaftësisë, fillimisht të plotë e pastaj të pjesshme, e shkaktuar nga thyerja e eshtrave të dorës. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 50 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit postraumatik. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 25 ditë.

Eksperti ka konstatuar se paditësi, për shkak të lëvizjeve në nyjën e bylyzykut të dorës së majtë në shkallë të mesme, dora jo dominuese, pas thyerjes shumëpjesëshe të kockës së rrezorit dhe thyerjes së kockës skafoide 8% në nivel të nyjës së bylyzykut, ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 8%. I njëjti nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *J.J*, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, si reagim i fuqishëm ndaj rrezikut të çastit (frikë nga vdekja momentale). Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 orë, e shfaqur në formë të konfuzionit, të brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje rreth 4 muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja, të cilat i kanë shkaktuar ankth, pagjumësi, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende, herë pas here.

Eksperti ortoped, Dr. Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *R.J*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, si ndrydhje në kokë, hundë dhe qafë, ndrydhje e shpatullës së majtë, ndrydhje në gjurin e majtë, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të lartë ka pasur 1 ditë, dhimbje të intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 18 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët ka edhe tani posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka theksuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 18 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *R.J*, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, si reagim i fuqishëm ndaj rrezikut të çastit (frikë nga vdekja momentale). Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje

prej 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar e zgjat edhe sot e kësaj dite.

Gjykata, ekspertizat mjekësore, atë të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, të punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Megjithatë, ekspertizat mjekësore në raport me paditësin R.J, edhe pse kanë provuar faktin lidhur me dëmin e pësuar, të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosje në këtë çështje juridike, pasi që kërkesëpadia e paditësit është refuzuar në tërësi.

Nga kuponët fiskal me numra 8024, i datës 29.10.2012 dhe 0010, i datës 29.10.2012, si dhe dëftesat me numra 0753479, 0771237, 0794295, 0788836 dhe 0034255, gjykata ka provuar faktin se paditësi A.J, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 23.00€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Nga Kuponi fiskal me numër 2, i datës 05.11.2012 dhe dëftesat me numra 0753478, 0034256, 0771239, 0789911, 0775712, 0794302 dhe 0788839, gjykata ka provuar faktin se paditësi G.J, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 30€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Nga dëftesat me numra 0775656, 0790089, 0775082, 0775568, 0788838, 0771235 dhe 0794301, gjykata ka provuar faktin se paditësi J.J, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 20.00€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 (gazeta zyrtare RSFJ numër 29, 26 maj 1978). Gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 pasi që dëmi është shkaktuar në kohën kur ligji në fjalë ka qenë në fuqi.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruuese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit

motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo material, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, i vitit 1978, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 154 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Me nenin 158 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.” Kurse me nenin 178, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullate mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë.”

Me nenin 155 të të njëjtit ligji përcaktohet se “Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psiqike (demi jomaterial).” Kurse me dispozitën e nenit 185, paragrafi 1 është përcaktuar mënyra e kompensimit të dëmit material, ashtu që me këtë dispozitë parashihet se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi.” Ndërsa me dispozitat e nenit 200 është rregulluar kompensimi në të holla i dëmit jo material, ashtu që sipas paragrafit 1 të nenit në fjalë “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.”

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 154 dhe 178 Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 dhe nenit 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se palët e paditura janë përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 154 dhe 178 Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 dhe nenit 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të

dëmit, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësve *A.J, G.J dhe J.J*, vlerësimi të ekspertizave mjekësore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa për të paditësin *R.J*, vendosi si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *A.J*, në shumë prej 1,200.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 1 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 18 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe sot.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, për paditësin *A.J*, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 840.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin *A.J*, ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 15 ditëve, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të paaftësisë së pjesshme, në kohëzgjatje prej 18 ditëve.

Në emër të shpenzimeve të shërimit, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 23.00€, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, dhe atë dëftesat me numra 0753479, 0771237, 0794295, 0788836 dhe 0034255, është provuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit, ka krijuar shpenzime të shërimit në shumë prej 23.00€, dhe të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *G.J.*, në shumë prej 1,320.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 1 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 20 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe tani, kohë pas kohe.

Në emër të kompensimit lidhur me frikën për paditësin *G.J.*, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 924.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin *G.J.*, ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, në kohëzgjatje prej 20 ditëve.

Në emër të shpenzimeve të shërimit, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit *G.J.* në shumë prej 30.00€, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, dhe atë Kuponi fiskal me numër 2, i datës 05.11.2012 dhe dëftesat me numra 0753478, 0034256, 0771239, 0789911, 0775712, 0794302 dhe 0788839, është provuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit, ka krijuar shpenzime të shërimit në shumë prej 30.00€, dhe të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata, ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kërkesëpadinë e paditësit *J.J.*, duke gjykuar shumat si në dispozitiv, pasi që në këtë rast kërkesëpadia e paditësit është drejtuar vetëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, e cila në vlerësimin e



gjykatës, nga baza e auto përgjegjësisë, ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit të pësuar nga paditësi në proporcion prej 30%. Andaj edhe shumat e aprovuara, me arsyetimet si më poshtë, i referohen proporcionit prej 30% të dëmit të pësuar në aksidentin e datës 25.10.2012, nga paditësi në fjalë.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit J.J, në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A., në shumë prej 618.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 45 minutave, dhimbje të intensitetit të rëndë 3 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 50 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe tani.

Në emër të kompensimit lidhur me frikën për paditësin J.J, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 432.60€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 2 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 4 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët ka ende.

Në emër të kompensimit për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata ka caktuar dëmshpërblimin në shumë prej 1,080.00€, sipas proporcionit të përgjegjësisë së të siguruarit të të paditurës, prej 30% e dëmit të vlerësuar prej 3,600.00€, duke pasur parasysh moshën e paditësit J.J në kohën e aksidentit dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit, zvogëlim ky që sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor, është 8%.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin J.J, ka caktuar kompensimin në shumën nga 120.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 50 ditëve.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 120.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën

mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, në kohëzgjatje prej 60 ditëve.

Në emër të shpenzimeve të shërimit, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit J.J në shumë prej 6.00€, në proporcion prej 30% të shpenzimeve të krijuara, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, dëftesat me numra 0775656, 0790089, 0775082, 0775568, 0788838, 0771235 dhe 0794301, është provuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit, ka krijuar shpenzime të shërimit në shumë prej 20.00€, dhe të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata, vlerëson se shumatat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që iu është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'u mundësoj paditësve satisfaksion që të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën do ta kishin po që se të njëjtat nuk do t'i kishin humbur, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe zvogëlimin e aktivitetit të përditshëm jetësor për paditësin J.J. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 200 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë e kujdes të huaj, ka aprovuar shumatat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 195, paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978, ku është përcaktuar se “ Kush i shkakton tjetrit lezonim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paafësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësve A.J, G.J dhe J.J, iu takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësit për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësve i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi

i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata paditësit *A.J* i ka njohur në tërësi, dëmin material lidhur me shpenzimet e shërimit, nga se me provat e administruara është provuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 25.10.2012, ka pasur shpenzime të shërimit në shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa paditësitve *G.J* dhe *J.J* u ka njohur pjesërisht dëmin material lidhur me shpenzimet e shërimit, pasi që për paditësin *G.J* i njëjti nuk ka provuar se ka pasur shpenzime mbi shumën e njohur me aktgjykim, kurse për paditësin *J.J* shpenzimet e njohura në shumë prej 6.00€ paraqesin 30% të vlerës së shpenzimeve të krijuara nga paditësi për shërim, e të cilat ishin 20.00€.

Gjykata, ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësitve *A.J*, *G.J* dhe *J.J*, që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Lidhur me dëmin material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësitve për shpenzimet e rehabilitimit klimaterik, në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që paditësit nuk kanë provuar shpenzime të krijuara për këtë qëllim. Ndërsa sa i përket dëmit material lidhur me shpenzimet e shërimit të paditësit *G.J*, gjykata ka refuzuar kërkesën në shumë prej 110.00€, nga se paditësi nuk ka provuar shpenzimet e kryera mbi shumën e aprovuara nga gjykata. Bazuar në dispozitën e nenit 7 dhe 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, paditësit kanë pasur barrën e provës për të provuar këto shpenzime.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e cila duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978, për dëmin material fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, 24.12.2012, ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 15.12.2022, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuara pretendimet e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, lidhur me përgjegjësinë e ndarë në shkaktimin e aksidentit të pjesëmarrësve në aksident, të siguruar tek të paditurat, në proporcion prej 50% me 50% ndërmjet të dy të paditurave, pasi që nga ekspertiza e Komunikacionit, e datës 05.08.2020, punuar nga eksperti Skender Shala dhe nga sqarimet e dhëna në seancë gjyqësore, është provuar fakti se përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit të datës 25.10.2012, ka pasur i siguruari tek Kompania e Sigurimeve “S.....”.

Gjykata ka vendosur si në pikën –VI- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit R.J, të drejtuar ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A., për dëmshpërblim të dëmit material dhe jo material, në lartësi të diferencës së dëmshpërblimit të kompensuar prej 20%, pasi që nga provat e administruara në këtë çështje juridike kontestimore, dhe atë Marrëveshja Jashtëgjyqësore, e datës 27.03.2013, është vërtetuar fakti se palët, këtu paditësi dhe e paditura, me vullnetin e tyre të lirë kanë arritur marrëveshjen në fjalë dhe janë dakorduar që lidhur me dëmin e pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 25.10.2012, i dëmtuarit, këtu paditësi R.J, nuk do të bëjë kërkesë dhe nuk do të ushtroj padi në të ardhmen për dëmin e pësuar dhe nëse ka ushtroar padi, të njëjtën do ta tërheq. Pra me këtë marrëveshje pala paditëse është kompensuar, në vlerën e pranuar prej tij, për të gjitha format e dëmit të pësuar në aksidentin në fjalë, dhe me vullnetin e tij të lirë është pajtuar se nuk do të bëjë kërkesë lidhur me të.

Gjykata bëri shtjellimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse kryesisht në arsyetimin e vendimit, i’u referuar provave që kishin ndikim vendimtar në vendosje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që të paditurat t’i bartin shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së OAK-së, për vlerën e kontestit deri në dhjetëmijë euro, sipas së cilës paditësve u pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 2,267.18€, të cilat duhet t’u kompensohen paditësve nga të paditurat, sipas proporcionit të përgjegjësisë, dhe atë e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për 70% të përgjegjësisë, për paditësit A.J dhe G.J, shumën prej 1,505.42€, ndërsa e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve “S.....”, për 30% të përgjegjësisë, për paditësit A.J, G.J dhe J.J, shumën prej 832.74€. Shpenzimet e procedurës të njohura paditësve janë: për përpilim të padisë shumën prej 171.60€, për përfaqësim e paditësve në gjashtë seanca të mbajtura dhe një seancë të shtyrë pa fajin e avokatit të palës paditëse

shumën prej 1,490.58€, për marrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150.00€, për marrjen e provës me ekspertiza mjekësore për paditësit A.J, G.J dhe J.J, shumën prej 430.00€ dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 25.00€. Shpenzimet e procedurës të njohura në këtë çështje juridike për përpilim të padisë dhe për përfaqësim të paditësve në seancat gjyqësore nga avokati, janë përlllogaritur bazuar në tariforin 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifatat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€ si dhe nenin 452, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që pjesa e aprovuar e padisë për të tre paditësit është nën vlerën 10,000.00€.Ndërsa të paditurat janë obliguar që të njëjtat t'ua kompensojnë paditësve, në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që kërkesëpadia e paditësve A.J dhe G.J është drejtuar ndaj dy të paditurave, kurse kërkesëpadia e paditësit J.J është drejtuar vetëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "S.....". Shpenzimet në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve "S....." janë njohur në proporcion prej 70% të vlerës së kompensimit për avokat, për përfaqësimin e dy paditësve, kurse në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve "S....." në proporcionin prej 70% të vlerës së kompensimit për avokat, për përfaqësimin e tre paditësve. Shpenzimet e krijuara për taksë gjyqësore për padi dhe marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i komunikacionit janë njohur në tërësi nga gjykata, dhe janë obliguar të paditurat që të njëjtat t'ia kompensojnë paditësve sipas proporcionit të përgjegjësisë së të paditurave (30% me 70%). Shpenzimet e krijuara për marrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë mbi shumën e shpenzimeve të njohura nga gjykata, i referohen shpenzimeve procedurale të paditësit R.J, kërkesëpadia e të cilit është refuzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet e procedurës mbi shumën prej 2,267.18€ e deri në 7,701.4€, apo shumën prej 5,434.22€, bazuar në suksesin e palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 452, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që paditësit pjesërisht kanë pasur sukses. Shumat e aprovuara nga gjykata janë nën vlerën 10,000.00€ të kontestit, ashtu që shpenzimet lidhur me përpilimin e padisë dhe përfaqësimin e paditësve janë njohur sipas tariforit 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifatat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€. Po ashtu gjykata nuk ka njohur edhe shpenzimet e kërkuara në shumë prej 624.00€ për parashtrësën e datës 22.06.2022 për ndryshimin dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.11.2022, pasi që ky kompensim është konsumuar me shpenzimet e njohura për padi dhe se parashtrësja në fjalë ka të bëjë me rregullimin e padisë në kuptimin objektiv.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.3447/12, datë 15.12.2022

Gjyqtari  
Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.